



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke



ZL.Anr.470/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi, anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ilir Ahmeti kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV), për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.Anr.470/2017 e datës 23.10.2017, e parashtruar nga Ilir Ahmeti, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë,

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga Ilir Ahmeti kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, me të cilën pretendon se është bërë shkelja e të drejtës së votës, si na: Shkolla Fillore “Skenderbeu” në fshatin Vaganicë, fshatin Zhabar, fshatin Shupkocv, fshatin Broboniq, në Vendvotimet 1105/B, 1101/B, 1129/B, 1117/B dhe 1103/B.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hedh si të palejuar ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpallja së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

Zl.Anr. 470/2017 me datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Paneli
Zyheri Maziri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.